



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2019:268540

Datë: 10.02.2022

Numri i dokumentit: 02700479

P.nr. 1015/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, – Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të akuzuarit G. K., nga fshati Zh., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.3602/19, (2019:0144546) të datës 18.11.2019, në mbështetje të nenit 358 par.1 nën par 1.3 të KPPK-ës, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë **09.02.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr. 3602/19, (2019:0144546) të datës 18.11.2019, **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit G. K., nga fshati Zh., komuna e V., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, e rikualifikuar nga Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2022, pasi që vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën veprë penale.

Pala e dëmtuar – Komuna e Vushtrrisë udhëzohet në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore – juridike.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.3602/19, (2019:0144546) të datës 18.11.2019, kundër të akuzuarit G. K. nga fshati Zh. komuna e Vushtrrisë për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.2 të KPRK-së, e ri kualifikuar nga Prokurorja e Shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2022, ashtu që në vend të par.2 duhet të jetë par.1 i nenit 349 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të lëndës si dhe shkresave të saj e duke vepruar në pajtim me nenin 358 të KPPK-së, ka vërejtur se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri në bazë të dispozitivit të aktakuzës, kallëzimit penal dhe në bazë të fletëparaqitjes të përgatitur nga Komuna e Vushtrrisë, lidhur me këtë çështje juridike, sasia e drunjëve të prerë është 1.98 m³ dhe kjo në

bazë të dispozitave të KPRK-së, përkatësisht nenit 349 par. 1 nuk përbën vepër penale, sepse me këtë nen përcaktohet dhe sanksionohet vepra penale vjedhja e pyllit në rastet kur sasia e drunjëve të prerë tejkalon sasinë prej 2 metra³.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.3 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të akuzuarit të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 358 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1015/19, datë 09.02.2022

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda tri (3) ditëve, nga dita e pranimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.